



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I ARTEVE
SENATI AKADEMIK

Nr. 1753 Prot.

Tiranë, më 12.12.2024

VENDIM

Nr. 22, Datë 12.12.2024

PËR

**CAKTIMIN E PERIUdhËS SË VETËKANDIDIMIT PËR ANËTARË NË
KOMISIONIN E PROMOVIMIT TË PERSONELIT AKADEMIK, NË
UNIVERSITETIN E ARTEVE**

Senati Akademik i Universitetit të Arteve, mbështetur në nenin 38, pika 1(i), nenin 46 të ligjit nr. 80/2015 “Për Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, në nenin 30, pika 3(a) dhe nenin 31 të Statutit të Universitetit të Arteve, në nenin 21, pika 2(a) dhe neni 22 të Rregullores së Universitetit të Arteve, në nenin 4, pikat 1(t) dhe 1(s) të Rregullores së Funkcionimit të Senatit Akademik në Universitetin e Arteve, si dhe në shkresat nr. 1726 prot. dhe 1727 prot., datë 06.12.2024, me votim të hapur,

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurës për marrjen e kandidaturave për 2 (dy) anëtarë, përfaqësues të Fakultetit të Arteve të Bukura, në Komisionin e Promovimit të Personelit Akademik në Universitetin e Arteve.
2. 2 (dy) anëtarët e Komisionit, nga 7 (shtatë) anëtarë gjithsej, vetëkandidohen dhe për zgjidhen nga Senati për një mandat dyvjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje.
3. Kandidatët duhet të plotësojnë këto kritere:
 - a. Të jenë pjesë e personelit akademik me kohë të plotë;
 - b. Të mbajnë titullin “Profesor” dhe të kenë së paku 5 (pesë) vite përvojë në mësimdhënie pas fitimit të këtij titulli.
4. Aplikimet duhet të paraqiten pranë Sekretariatit Teknik të Senatit Akademik, nga data 13.12.2024 deri më datë 18.12.2024, nga ora 08:00, deri më 16:00.
5. Ky vendim të shpallet në faqen zyrtare të Universitetit të Arteve dhe tek transparenca.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.



SENATI AKADEMIK I UNIVERSITETIT TË ARTEVE

Prof. Dr. Erald BAKALLI

Prof. Najada HAMZA

Prof. Arben LLOZI

Prof. Miltiadh KUTALI

Prof. Sadik SPAHIJA

Prof. Lorenc RADOVANI

Prof. Vladimir MYRTEZAJ (GROSHA)

Prof. Endri SINA

Prof. Rudina CIKO

Prof. Gazmend GJOKA

Prof. Asoc. Dorian ÇENE

Prof. Asoc. Albes FUSHA

Prof. Asoc. Edmond GJIKOPULLI

Prof. Asoc. Kristina LAÇO

Prof. Asoc. Genci FUGA

Prof. Asoc. Alert ÇELOALIAJ

Prof. Asoc. Orion Shima

Enea TRIMI (Student FAB)

Rei KITA (Student FM)

